



Pranimar / Doretuar Prilbim / Prilbim Received / Received	08.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organi / Njësia Org / Unit	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKQZ	6909/2022		15



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PER SHERBIMIN CIVIL TE KOSOVES
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUZBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.36/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.820/2018 të datës 29.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.237/21 të datës 07.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.36/2018 të datës 26.01.2018 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga kundër organit të punësimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në çështjen juridike “kundër Vendimit me numër protokolli 2729/2017 i datës 29.12.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.36/2018 e datës 16.03.2018 të ankueses

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas akt emërimit të datës 27.12.2011 në pozitën Zyrtar i Lartë i Çertifikimit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datën 06.09.2017 ka parashtruar ankesën me numër 1586/2017 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKQZ me pretendimin për trajtim të kësaj pozite si pozite e nivelit drejtues Grada e pagës 5.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 02.10.2017 nxjerr Vendim me numër 1860/2017 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën me numër 1586 të datës 06.09.2017 të parashtruar nga ankuesja.

Ankuesja e pakënaqur me mos ekzekutimin e Vendimit me numër 1860/2017 të datës 02.10.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, më datën 27.10.2017 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5503/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.10.2017 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më datë 07.11.2017 Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura nga faqe 1-47.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave me vendimin nr.A 02/683/2017 të datës 18.12.2017 ka obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, që të bëjë rishqyrtimin e ankesës me numër 1586 të datës 06.09.2017 të parashtruar nga ankuesja brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin e datës 29.12.2017 me numër protokollit 2729 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 26.01.2018 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 397/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 16.03.2018 ka nxjerr Vendim A.nr.36/2018 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi Vendimin me Nr.Prot: 2729/2017 të datës 29.12.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pasi që ankuesja ka filluar konfliktin administrativ, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 09.12.2020 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.820/2018, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Me datën 29.09.2022 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë paditëses duke obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të ri vendos për ankesën e datës 26.01.2018, mirëpo ankuesja kundër Aktgjykimit A.nr.820/2018 të datës 29.09.2022 Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, rrjedhimisht ka pezulluar efektet e këtij aktgjykimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.820/2018 të datës 29.09.2022 të Gjykatës Themelore



në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.237/21 të datës 07.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.820/2018 të datës 09.12.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Autorizimi i datës 16.11.2020 me numër protokollin 2601/2020; Përgjigje në padi e datës 14.02.2020 me numër protokollin 358/2020; Padia e datës 10.04.2018 e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbali i datës 18.06.2019 i seancës për Autorizim i datës 14.05.2019 me numër protokollin 2294/2019; Përgjigje në padi e datës 31.12.2018 me numër protokollin 8078/2018; Aktvendimi A.nr.82/2018 i datës 20.12.2018 me numër protokollin 7830/2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Padia e datës 19.01.2018; Vendimi A 02/683/2017 i datës 18.12.2017 me numër protokollin 6618/2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 26.01.2018 me numër protokollin 397/2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 29.12.2017 me numër protokollin 2729/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Njoftim i datës 08.12.2016 me nr 1281/2016 për Aktgjykimin , rastin nr.KO 73/16 të Gjykatës Kushtetuese; Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr.KO73/16; Formular për regjistrin e gradave; Njoftimi i datës 29.12.2017 me numër protokollin 6897/2017; Ankesa e datës 27.10.2017 me numër protokollin 5503/2017 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 24.10.2017; E-mail zyrtar i datës 17.10.2017; E-mail zyrtar i datës 12.10.2017; Vendimi i datës 02.10.2017 me numër protokollin 1860/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mail zyrtar i datës 02.11.2017; Ankesë e datës 06.09.2017 me numër protokollin 1586/2017 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; E-mail zyrtar i datës 18.10.2017; E-mail zyrtar i datës 18.08.2017; Kërkesë e datës 16.08.2017 për shqyrtimin e koeficientit të zyrtarit të lartë certifikues; E-mail zyrtar i datës 14.08.2017; E-mail zyrtar i datës 20.03.2017; Përshkrimi i detyrave të punës; Rishpallje e vendeve të punës; Akt emërimi i datës 27.12.2011; Formulari i Vlerësimit të kryerjes së punës për vitin 2012; Formulari i vlerësimit të punëve për vitin 2013; Formulari i vendimit të punës për vitin 2015; formulari i vlerësimit të kryerjes së punës i datës 15.11.2011; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 02.01.2010; Autorizim i datës 03.10.2022; Procesverbali i datës 29.09.2022; Dorëzimi i provave me shkrim përmes përfaqësuesit ligjor i datës 29.08.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.12.2020; Listat e pagave në bazë të Rregullores së re të vitit 2019; Lista e pagave me rregullore të vjetër; Procesverbal i seancës i datës 28.07.2022; Autorizim i datës 28.07.2022 me numër protokollin 4375/2022; Ankesë e datës 16.02.2021 me numër protokollin 648/2021 e parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës nga përmes përfaqësuesit ligjor; Vendimi A.nr.36/2018 me numër protokollin 1559/2018 i datës 16.03.2018; Procesverbal i Kolegjit për Ankesa të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A 02/683/2017 i datës 18.12.2017 me numër protokollin 6618/2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbali i Kolegjit për ankesa të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje plotësuese nga Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor i datës 14.11.2017 me numër protokollin 2270/2017; Përgjigje nga Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor i datës 07.11.2017 me numër protokollin 5675/2017; Ankesa me numër protokollin 5503/2017 e datës

27.10.2017 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rregullore Nr.02/2017 për përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e datës 10.03.2017; Formulari për regjistrimin e gradave; Ankesë e datës 07.09.2017 me numër protokolli 1661/2017 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 02.10.2022; E-mail zyrtar i datës 02.10.2022; E-mail zyrtar i datës 14.09.2022; E-mail zyrtar i datës 26.09.2022; Akt emërimi i datës 02.01.2012; Kërkesë e datës 27.10.2017 me numër protokolli 2097/2017 për rivendosje në vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për E-mail zyrtar i datës 04.10.2017; E-mail zyrtar i datës 27.10.2017; E-mail zyrtar i datës 26.10.2017; E-mail zyrtar i datës 04.10.2017; Procesverbali i datës 26.10.2017 nga seanca e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe E-mail zyrtar i datës 07.11.2022 nga Menaxherja e Personelit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore për pezullim të procedurës në lidhje me këtë ankesë të ankueses
sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me datën 16.03.2018 ka nxjerr vendimin A.nr.36/2018, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar. Ankuesja e pakënaqur me vendimin e Këshillit me datën 18.04.2018 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative e cila ka kërkuar që të anulohet Vendimi A.nr.36/2018 i datës 16.03.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.820/18 të datës 09.12.2020 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Kundër Aktgjykimit A.nr.820/18 të datës 09.12.2020 përfaqësuesi ligjor i ankueses me datën 02.02.2021 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit të Kosovës me datë 07.06.2022 mori Aktvendimin AA.nr.237/2021 me të cilin aprovon ankesën e paditëses si të bazuar duke prishur Aktgjykimin A.nr.820/18 të datës 09.12.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë me datën 29.09.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.820/18 me të cilin aprovon kërkesëpadinë e paditëses dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës. Me datën 04.11.2022 Këshilli ka pranuar kopjen e ankesës drejtuar Gjykatës së Apelit që e ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i ankueses në Gjykatën e Apelit të Kosovës me datën 01.11.2022 për të njëjtin objekt shqyrtimi sipas kësaj ankese, dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*,



ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që rishqyrtimi i lëndës-ankesës A.nr.36/2018 e datës 16.03.2018 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata e Apelit të Kosovës sipas ankesës së datës 04.11.2022 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankueses, pasi që objekti i shqyrtimit është i njëjtë dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas vendosjes së rastit nga Gjykata e Apelit të Kosovës dhe njoftimit të këshillit në lidhje me këtë vendimmarrje nga ana e palëve në procedurë, sipas ankesës së paditëses ndërlidhur me rastin që për objekt të shqyrtimit ka anulimin e vendimit A.nr.36/2018 të datës 16.03.2018 të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, do të vendosë në lidhje me rastin varësisht nga obligimi gjyqësor që mund të rrjedhë në lidhje me këtë lëndë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.36/2018, datë 08/11/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Prishtinë;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.